

Funded
by the European Union
and the Council of Europe



Implemented
by the Council of Europe

Përshkrimi i Pyetësorit për komponentët anti-korrupsion (AK)

Projekti kundër korrupsionit në Kosovë - PECK¹

1. Hyrja dhe qëllimi i pyetësorit

Pyetësori është një instrument parësor në procesin vlerësues për të mbledhur informacione paraprake rreth kornizës rregullative dhe institucionale në Kosovë. Këto informacione formojnë bazën e vlerësimit dhe shfrytëzohen nga ekipi i ekspertëve për të formuar një kuptueshmëri të plotë të masave ekzistuese, për të hartuar të gjeturat fillestare dhe për të identifikuar fushat problematike dhe çështjet e tjera që duhet të diskutohen edhe më tej gjatë rrjedhës së vizitës në terren.

2. Natyra dhe fushëveprimi i pyetjeve

Pyetësori bazohet në standardet ndërkombëtare dhe evropiane kundër korrupsionit me theks të veçantë në metodologjinë GRECO, përfshirë edhe Konventën e Ligjit Penal Kundër Korrupsionit (ETS Nr. 173), Rekomandimet e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës (2003)⁴ mbi rregullat e përgjithshme kundër korrupsionit gjatë financimit të partive politike dhe fushatave elektorale.

Pyetësorët trajtojnë një varg fushash kyçe që janë të rëndësishme për regjimin anti-korrupsion. Pjesa e parë tematike trajton mbrojtjen themelore dhe parandalimin e korrupsionit për autoritetet gjyqësore dhe prokuroriale, policinë, anëtarët e parlamentit dhe të administratës publike, masat për të siguruar transparencën e financimit të partive politike dhe prokurimit publik. Pjesa e dytë i kushtohet çështjeve që kanë të bëjnë me veprat penale dhe sanksionet, përfshirë edhe për personat juridikë, hetimeve dhe procedurave penale dhe të konfiskimit, si dhe çështjeve të imunitetit nga ndjekja penale. Pjesa e fundit i kushtohet mekanizmave ligjorë dhe proceduralë për bashkëpunim ndërkombëtar. Shumica e pyetjeve janë ndër-sektorale, andaj edhe kërkojnë informacione nga shumë agjenci.

Pyetësori dhe ushtrimi i vlerësimit në përgjithësi nuk përqendrohen vetëm në masat ekzistuese në një moment të caktuar, por po ashtu synojnë të nxjerrin informacione rreth ndryshimeve të planifikuara rregullative dhe institucionale në Kosovë.

3. Hapat e radhës

Projekti do të përfshijë një seminar shpjegues për autoritetet në Kosovë mbi detajet dhe teknikat për plotësimin e pyetësorëve në maj të vitit 2012. Pyetësori më pastaj do t'u dorëzohet autoriteteve të Kosovës në fund të muajit maj – fillim të qershorit me një afat prej dy muajsh për dorëzimin e përgjigjeve.

¹ Çdo përmendje e Kosovës, qoftë si territor, institucion ose popullatë, në këtë tekst duhet të kuptohet në përputhje të plotë me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe pa paragjykim ndaj statusit të Kosovës.